



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 3 shtator 2020

Z. Bahri Hyseni, Kryesues
Këshilli Prokurorial i Kosovës
Rr. "Luan Haradinaj", nr.16/1
Zona II, kategoria II

Letër rekomandimi

Ankesa nr. 280/2020
kundër
Këshillit Prokurorial të Kosovës

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 21 të Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, më 20 prill 2020, ka pranuar ankesë nga znj. Serbeze Haxhiaj, gazetare e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), parashtruar kundër Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), për shkak të refuzimit të kërkesës për qasje në informacion nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK).

Ankuesja, më 25 mars dhe më 9 prill 2020, i është drejtuar kryeprokurorit të PSRK-së me kërkesë për qasje në informacion. Në kërkesën e datës 25 mars 2020, ankuesja ka kërkuar përgjigje në pyetjet:

- 1. A kanë aktualisht autoritet në Kosovë arkiva të sistemuara të dokumenteve dhe materialeve të tjera të rasteve për krime lufte që janë përdorur ose mund të përdoren ende në procese gjyqësore. Nëse po, si po shfrytëzohen aktualisht këto materiale të prokurorive vendore të rasteve për krime lufte?*
- 2. Cilat janë sfidat më të mëdha të autoriteteve të prokurorisë në Kosovë sa i përket qasjes në arkivat për krime lufte, sidomos ato që kanë qenë nën menaxhim të misionit të OKB-së fillimisht por më vonë edhe atij të BE-së?*
- 3. A ka sistemi juridik i Kosovës ndonjë politikë të veçantë se çfarë do të bëjë me këto materiale?*
- 4. A ka pasur deri më tani ndonjë bashkëpunim me Tribunalin e Hagës për sa i përket shfrytëzimit të arkivave të Tribunalit për rastet e krimeve të luftës në Kosovës, sidomos çështjen e të zhdukurve?¹*

Ndërsa në kërkesën e datës 9 prill 2020, ankuesja ka kërkuar përgjigje në pyetjet në vijim:

¹ Kërkesa e ankueses, e datës 25 mars 2020, parashtruar nëpërmjet postës elektronike, në PSRK

1. Vitin e kaluar Këshilli Prokurorial i Kosovës miratoi një Strategji e krimeve të luftës, në përpjekje për të rritur progresin në ndjekjen e krimeve të luftës të kryera nga Serbia në Kosovë. Për gati një vit cilat kanë qenë çështjet kryesore në të cilat është punuar në këtë strategji?

2. Është thënë se kjo strategji do t'i japë përparësi hetimit të disa prej masakrave më të mëdha të kryera gjatë luftës në Kosovë. Në sa raste të masakrave janë hapur hetime deri më tani dhe a është masakra e Mejës njëra prej tyre?

3. Familjarët e viktimave të masakrës së Mejës thonë se një pjesë të materialit dhe dëshmime u është dorëzuar së fundi hetuesve në Kosovë. A është kjo një hap që sinjalizon se mund të vihet në lëvizje mekanizmi hetues për rastet që më herët misionet ndërkombëtare nuk patën sukses?

4. Masakra e Mejës është një prej rasteve për të cilat Tribunali i Hagës ka dënuar tre persona në zinxhirin e lartë komandues të Serbisë. A përbën ky fakt një anë lehtësuese për të zhvilluar hetime të tjera nga autoritete e drejtësisë në Kosovë?

5. Në zemër të strategjisë për hetimin e krimeve të luftës është fokusimi te zinxhiri i përgjegjësive komanduese. Sa e mundur është kjo aktualisht për prokurorinë duke pasur parasysh nivelin pothuajse zero të bashkëpunimit juridik Kosovë – Serbi?²

Në kërkesën e parë, ankuesja, nëpërmjet postës elektronike, ka marrë një përgjigje nga kryeprokurori i PSRK-së, përmes së cilës është njoftuar se përgjigjen mund ta marrë pas kalimit të pandemisë, ndërsa në kërkesën e dytë nuk ka marrë fare përgjigje. Për më tepër, ankuesja ka pohuar se është ballafaquar me refuzim dhe injorim në kërkesat e saj për qasje në informacion nga Zyra për Komunikim me Publikun e Prokurorisë, përveç në rastet kur janë përgjigjur prokurorët personalisht.

Më 4 maj 2020, Avokati i Popullit iu ka drejtuar me shkresë kryesuesit të KPK-së dhe PSRK-së përkitazi me ankesën në fjalë. Më 14 maj 2020, Avokati i Popullit ka marrë një përgjigje nga kryesuesi i KPK-së, përmes së cilës është njoftuar për veprimet që KPK-ja i ka ndërmarrë përkitazi me kërkesën e ankueses për informacion dhe se për disa nga pyetjet e drejtuara nuk mund të japin informacion, meqenëse kanë të bëjnë me procesin e hetimeve, ndërsa për pyetjet e tjera do t'ia ofrojnë përgjigjet në një periudhë sa më të shkurtër. Po ashtu, më 19 maj 2020, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga kryeprokurori i PSRK-së, përmes së cilës është njoftuar se, për shkak të gjendjes së pandemisë Covid-19, i kanë realizuar vetëm veprimtaritë e natyrës urgjente dhe sapo të fillojnë me punë në kushte normale, do t'i japin përgjigje ankueses. Meqenëse nga kjo përgjigje e fundit ka kaluar një muaj dhe ankuesja nuk ka marrë përgjigje në kërkesën e saj për informacion, Avokati i Popullit, më 16 qershor 2020, iu ka drejtuar përsëri me shkresë kryesuesit të KPK-së dhe kryeprokurorit të PSRK-së. Megjithatë, as Avokati i Popullit dhe as ankuesja nuk kanë marrë përgjigje.

Me këtë rast, Avokati i Popullit jua rikujton se kërkesat për qasje në dokumente publike që i drejtohen institucioneve publike nga qytetarë, nga shoqëria civile, nga mediat etj., janë kërkesa të cilat parashtrihen duke u nisur nga garancitë kushtetuese e ligjore në vend. Kushtetuta, në nenin 41, paragrafi 1, përcakton: “*Secili person gëzon të drejtën e qasjes në*

² Kërkesa e ankueses, e datës 9 prill 2020, parashtruar nëpërmjet postës elektronike në KPK.

dokumente publike.”; dhe në paragrafin 2 përcakton se: “Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.”

Po ashtu, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen të Ligji nr. 06/L-81 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), i cili zbatohet për të gjitha dokumentet publike që prodhohen, pranohen, mbahen apo kontrollohen nga institucionet publike, përveç në rastet kur kufizohet ndryshe me legjislacionin në fuqi.

Ndërsa refuzimet lidhur me të drejtën për qasje në dokumente publike janë të përcaktuara në nenin 17 të LQDP-së, në bazë të të cilit një institucion publik nuk mund të refuzojë të tregojë nëse e ka në posedim një dokument apo ta refuzojë qasjen në një dokument publik, përderisa nuk bën një test të dëmit dhe të interesit publik për ta përcaktuar nëse dëmi i shkaktuar ndaj interesit të mbrojtur mbisundon interesin e publikut për qasje në atë dokument publik.

Për më tepër, duhet pasur parasysh se praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), sipas nenit 53 të Kushtetutës, paraqet bazë për interpretimin e të drejtave të njeriut. Ndërsa GjEDNj-ja në praktikën e saj vazhdimisht ka vlerësuar: *“Liria e shprehjes përbën një nga themelet esenciale të një shoqërie demokratike, bazuar në paragrafin 2 të nenit 10 të KEDNj, dhe është e zbatueshme jo vetëm për “informacion” apo “ide” të cilat pranohen apo vlerësohen. [...] Jo vetëm që shtypi ka për detyrë të transmetojë informacione dhe ide të tilla, por publiku gjithashtu ka të drejtë t'i pranojë ato. Sikur të ishte ndryshe, shtypi nuk do të ishte në gjendje të luante rolin e tij jetësor të “mbikëqyrësit publik.”³ Në rastin *Lingens v. Austria*, GjEDNj-ja jua rikujton: “[...] të tilla janë kërkesat e pluralizmit, tolerancës dhe mendjegjerësisë, pa të cilat nuk ka “shoqëri demokratike”. Këto parime kanë një rëndësi të veçantë për sa i përket shtypit. [...]”⁴*

E drejta për t'u informuar është e drejtë e garantuar me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 19 i së cilës përcakton: *“Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë.”*

Lirinë për të marrë dhe për të dhënë informacion e parasheh edhe neni 10, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) - [Liria e Shprehjes]: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë...”*

Trajtimi i kërkesave për qasje në dokumente publike është detyrim ligjor për të gjitha subjektet që ushtrojnë autorizime publike. Rrjedhimisht, kërkesat për qasje në dokumente publike, të parashtruara në institucione që ushtrojnë autorizime publike, nuk mund të trajtohen ndryshe përveçse sipas dispozitave ligjore në fuqi. Prandaj, t'ia mohosh publikut informacionet lidhur me funksionimin e organeve të shtetit, do të thotë ta shkelësh të drejtën

³ Rasti *Observer and Guardian V. The United Kingdom* (Aplikimi nr.13585/88, 26 nëntor 1991, paragrafi 59 (a) (b)).

⁴ Case of *Lingens V. Austria* (App. no_9815/82), 8 July 1986, paragraph 41.)

themelore të demokracisë.⁵

Gjendja emergjente e shpallur nga Qeveria e Republikës së Kosovës nuk duhet të paraqitet pengesë në drejtim të dhënies së informacionit për media dhe për publikun.

E drejta për qasje në dokumente publike e secilit person, si dhe garantimi dhe përmbushja e kësaj të drejte nga ana e institucioneve publike, përbën një prej themeleve të institucioneve demokratike dhe transparente. Hapja e të dhënave dhe transparencën në sektorin publik shërben për llogaridhënie ndaj publikut, për zhvillimin dhe avancimin shoqëror, ekonomik dhe demokratik.

Avokati i Popullit konstaton se, në rastin në fjalë, KPK-ja ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve lidhur me mundësimin, përkatësisht në dhënien e informacionit me kohë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Duke qenë se kërkesja e dokumentit/të dhënave është gazetare dhe këto të dhëna i ka kërkuar lidhur me aktivitetin që e zhvillon në informimin e publikut dhe konsiderohet si element thelbësor për të zhvilluar një debat në interes të publikut, ndërsa kontributi i mediave dhe i shoqërisë civile është i rëndësishëm në diskutimin e çështjeve me interes publik.

Me qëllim të përmirësimit të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, në mënyrë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë si mjet të fuqishëm për kontrollin e punës së organeve të pushtetit e që do të ndikonte në përmirësimin e punës së organeve shtetërore dhe rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, u

REKOMANDON

Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorisë Speciale:

- *Ta trajtojnë kërkesën e ankueses dhe t'ia ofrojnë informacionet e kërkuara, në pajtim me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

⁵ Rasti *Observer And Guardian V. The United Kingdom* (Aplikimi nr.13585/88, 26 nëntor 1991).